



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:238031

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06505070

2019:238032 (P. nr. 1152/19)

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve E.H., M.Q. dhe R.L. për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativ nga neni 315 par.1 nën par 1.1 lidhur me nenet 31 dhe 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të akuzuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.1820-10/19, të dt. 15.10.2019, ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore publike me datat 19.12.2023, 21.01.2024, 22.04.2024, 22.05.2024, 16.10.2024 dhe 07.11.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Ardian Emini, palës së dëmtuar A.N., të dëshmitarëve, B.N., B.V. dhe K.B., të akuzuarve dhe mbrojtësve të akuzuarve, av. Dalip Bega mbrojtës me autorizim i të akuzuarit E.H., av. Rafiz Shehu mbrojtës sipas detyrës zyrtare i të akuzuarit M.Q. dhe av. Miftar Islami mbrojtës i sipas detyrës zyrtare i të akuzuarit R.L., me dt. 11.11. 2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I akuzuari E.H., nga i ati Xh., e ëma G., e gjinisë J., i lindur me dt....., me vendbanim në Ferizaj rruga “....” numër ., nr. personal, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për vepëra penale tjera, ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera penale.

II akuzuari M.Q., nga i ati T., e ëma K., e gjinisë R., i lindur me dt..., në Kaçanik, me vendbanim në Ferizaj rruga “.....”, (ndërtesat ...) kati i .., nr. personal, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për vepëra tjera penale, ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera penale.

III akuzuari R.L., nga i ati S., e ëma Sh..., e gjinisë A., i lindur me dt..... në Prishtinë, me vendbanim në Ferizaj, rrugën “.....”, banesa “....” hyrja mbrapa kati i .. numër ..., nr. personal 1....., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për veprër penale, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Në kuptim të nenit 362 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-së.

REFUZOHET AKUZA

Sepse me dt.03.09.2019, rreth orës 00:30 në fshatin, K. Ferizaj, saktësisht në oborrin e të dëmtuarit A.N., duke hequr pengesat dhe depërtuar me forcë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, në bashkëkryerje kanë tentuar ta marrin pasurinë e personit tjetër, në atë mënyrë që pasi kanë këputur zingjirët e ekskavatorit dhe këputur kabllot e baterive të kamionit, kanë tentuar të kryejnë vjedhje të naftës nga kamionët dhe ekskavatorët pronë e të dëmtuarit, por i dëmtuari i kishte vërejtur dhe të pandehurit kishin filluar të ikin, pastaj i dëmtuari i kishte takuar afër restorantit “..... “ dhe e kishte njoftuar policinë.

- me çka në bashkëkryerje do të kryenin veprën penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nën par 1.1 lidhur me nenet 31 dhe 28 të KPRK-së.

Meqë Prokurori i shtetit, në fund të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarve E.H., M.Q. dhe R.L. për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nën par 1.1 lidhur me nenet 31 dhe 28 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr. PP/II.nr. 1820-10/19, të dt. 15.10.2019, ka akuzuar të akuzuarit për bashkëkryerje të veprës

penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nën par 1.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimet gjyqësore me datat 19.12.2023, 21.01.2024, 22.04.2024, 22.05.2024, 16.10.2024 dhe 07.11.2024, në të cilat shqyrtime gjyqësore kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit, pala e dëmtuar, dëshmitarët, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, të akuzuarit gjatë gjithë shqyrtimeve gjyqësore nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale që i është ngarkuar në aktakuzë duke theksuar se nuk janë kryes të veprës penale e cila u ngarkohet në bazë të aktakuzës, ndërsa prokurori i shtetit pas administrimit të gjitha prova materiale dhe personale në përfundim të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale kundër të gjithë të akuzuarve, për shkak të bashkëkryerje të veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nën par 1.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së, duke deklaruar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer vepër penale.

Pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të akuzuarve, gjykata në bazë të neni 362 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-së, refuzoi akuzën siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale, është i bazuar në nenin 454 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
2019:238032, (P. nr. 1152/19), me datë 11.11.2024

Zyrtare ligjore,
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 dite, nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.